



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 437/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Istog kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1650 (njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 02.11.2013, LVV-ja ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 02.11.2013, në rrugën “Rinia” në Istog, kanë vendosur banerin e kandidatës së tyre mbi rrugë publike, në afërsi të gjimnazit “Haxhi Zeka”, e njëjta do të jetë Qendër e Votimit (QV) në Zgjedhjet Lokale. Më tutje ka shtuar se, shkelja e dytë është kryer në afërsi të shkollës, pra më afër se 100 m. nga QV, ku është vendosur materiali i këtij subjekti politik. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me rregullat zgjedhore, me nenin 33 pika b e LZP-së, nenin 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013.. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.11.2013 deri në ora 19:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, lidhur me ankesën Anr.437/2013, ku ka theksuar se, vendosja e banerit për kryetare komune në Istog, mbi rrugë publike nuk është bërë nga strukturat e AAK-së, por vendosja e banerit mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të pa identifikuar. Për më tepër ka shtuar se, me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës, më konkretisht Shtabin Zgjedhor për Komunën e Istogut, për ta bërë heqjen e këtij baneri .

Në përgjigje në ankesë i ka bashkangjitur provat si në vijim :

Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së

Fotografinë me të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterit .

Kërkesën drejtuar shefave të Shtabeve Zgjedhore, për respektimin e Kodit Zgjedhor

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se, si baneri i subjektit politik AAK është vendosur në të dy anët mbi rrugën publike, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik AAK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika b) të LZP-së, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e posterëve mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik AAK, përveq thënieve se veprimet e tilla nuk janë kryer nga strukturat e AAK-së, me pretendimin se vendosja posterit është bërë nga individ apo qytetarë të pa identifikuar. Për më tepër, në mes tjerash theksohet se, si dëshmi është bashkangjitur fotografia në të cilën dëshmohet largimi i posterit, mirëpo për rastin në fjalë nuk është ofruar asnjë dëshmi që kanë ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar, siç kërkohet nga dispozitat e nenit 32.6 të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase e ka vendosur banerin e tyre mbi rrugët publike, shkelje për të cilën është i paraparë dënimi me gjobë, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 437/2013 më datën 04.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoja e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*